


# Q-MAGAZINE

EDICIONI NR.4

GUSHT 2012



# QUEER!





# QUEER Heteroseksualiteti nuk është Normal, vetëm i zakonshëm!

*Nga Lola Krasniqi*

Termi “Queer” është vështirë të përkufizohet dhe mund të nënkuptoj çdo gjë - nga kritika deri te teoria, varësisht nga ajo se si e shihni ju. Kritika përfshin (ose mund të konsiderohet) mospëlqimin se si personat gej, biseksual dhe transgjnorë shprehen se nuk mund të “përshtaten” dhe ndodh vazhdimisht në margjinat e botës ku ekziston fuqia dhe privilegji. Aktivizmi queer në format e veprimeve të ndryshme është gjithashtu një mënyrë tjetër që kritikon haptas shoqërinë normative heteroseksuale që nuk jep hapësirë për dhe diskriminon personat queer, d.m.th individët të cilët nuk i përshtaten strukturës normative.

Si teori, teoria e queer, është një mënyrë e re të shikuarit dhe kuptuarit të botës, në mënyrë që do ishte më gjithëpërfshirëse dhe e hapur për personat gej, lezbik, biseksual, transgjnor, aseksual, etj. Në fushën teorike mund të dallohen tri tema qendrore: heteronormativiteti, seksualiteti dhe gjinia.

Queer është një term që është më “i gjerë” dhe gjithëpërfshirës se termat gej dhe lezbike. Kjo përfshin të gjithë ata që e vendosin veten jashtë heteroseksualitetit normativ (madje edhe heteroseksualet që nuk shfaqin sjellje që përputhen me normën heteroseksuale). Queer nuk konsiderohet si identitet i pastër dhe i definuar. Teoricieni i famshëm dhe i njohur mbi çështjet queer është Don Kulick, Profesor i Antropologjisë Sociale në Universitetin e Stokholmit dhe formulimi i tij për queer thotë: “një fjalë që nënkupton mënyrën e veçantë për të analizuar dhe vepruar në shoqëri dhe identiteti i cili është zhvilluar në sajë të aftësisë për të kuptuar shoqërinë në një mënyrë politikisht të ndërgjegjshme”.


## *Teoria Queer*

Teoria queer është paraqitur në Shtetet e Bashkuara me rrënjët e saj në aktivizëm gej, feminizëm, post-strukturalizëm, filozofi dhe “studimet gej dhe lezbike”. Fjala queer e ka kuptimin e fjalës “ndryshe” ose “devijues” dhe në kuptimin shkencor teoria Queer jep vëmendje në funksionet e shoqërisë që kanë të bëjnë me fuqinë, seksualitetin, kapacitetin e normalizuar dhe gjininë. Nuk është interesante të tregohet se çka të tjerët shohin të jetë normë jonormale (jo-heteroseksuale) por e përfshinë atë në “normat standarde”. Nuk ekziston teoria queer si e tillë por më shumë paraqet një emër të përbashkët për perspektivat e ndryshme kritike mbi seksualitetin. Teoria queer është një numër i perspektivave të ndryshme. Identiteti, shoqëria dhe kultura mund të interpretohen në disa mënyra. Por emërtuesi i përbashkët i

teoricienëve queer është se ata duan të përqëndrohen më gjerë në seksualitetin në shoqëri. Ata nuk duan të studiojnë “devijuesen” por interesohen se si lindin, funksionojnë, ruhen dhe zbatohen normat seksuale. Pyetjet që mund të ngritën janë: “Çka është seksualiteti? Si kanë ndryshuar historikisht perceptimet mbi seksualitetin? Çfarë raporti ka seksualiteti me nocionet e feminitetit dhe mashkullitetit? Dhe çfarë ka të bëjë fuqia me këtë?” Theksi është të observohet se seksualiteti është disi i paqartë dhe nuk mund të shpjegohet, identifikohet dhe/ose ndahet lehtë nga fenomenet e tjera por ndonjëherë seksualiteti ka të bëjë me identitetin, ndonjëherë është një veprim, ndonjëherë mund ta analizosh më së miri përmes sistemit të normave dhe ndonjëherë është një dëshirë.

Ky term gjithashtu përdoret si një term gjithëpërfshirës për të gjitha dhe nuk përshtatet në normën heteroseksuale. Në vend që të specifikohen queer si një teori apo kategori e saktë dhe posaçërisht dalluese, shumë nga studiuesit thonë se teoria queer është “të çohen përpara, të përçahën dhe ndërprehen kategoritë dhe standardet e ndryshme.”

Teoria queer përfshin fusha të ndryshme studiuuese por fusha më e zakonshme është heteronormativiteti. Heteronormativiteti nënkupton se mund të pretendohet se ne të gjithë jetojmë një jetë heteroseksuale dhe/ose është një mënyrë natyrale e të jetuarit. Ky supozim bëhet përditë nga institucionet, ligjet, marrëdhëniet dhe veprimet siç është kur një çift me gjini të njëjtë nuk përfshihet në ligjin martesor, kur kujdesi shëndetësor i vendit nuk lejon inseminimin e lezbikeve ose injorohet perspektiva e LGBT kur shkruhet një libër edukues. Ata të cilët trajtohen si “jo-heteroseksualet” është diçka që nuk përfshihet në normë dhe bëhet anormale kur krahasohet



me atë “normalen”. Teoriceni queer do që të shoh se si identitetet, aktet, rregullat, normat dhe besimet janë të thurura së bashku në atë që quhet seksualitet. Një nga standardet e teorive queer është se normalizimi lidhet me fuqinë.

### **Queer në Politikë - Rilindja e fjalës QUEER**

Aktivizmi queer përfshinë një qasje sfiduese ndaj politikave seksuale dhe kjo nuk i shmanget kontroverses e as konfrontimit. Diskutimet lidhur radikalizmin politik të aktivizimit zakonisht sërish viziton modelin e të gjitha aktivizimeve queer, organizimit në anën tjetër të Queer Nation që i është dhënë merita për përdorimin e parë të fjalës queer si një shenjë dalluese politike në fletushkat legjendare me titujt “Queer-et Lexoni Këtë!”, dhe “I urrej njerëzit Straight!”

Rritur nga frustrimi me keq-menaxhimin e qëllimshëm të krizës së SIDA-s nga ana e qeverisë dhe me dhunën, homofobinë, diskriminimin dhe armiqësinë e rritur, përgjigjet me zemërim dhe të dhunshme është veçori sensacionale e fletushkës dhe politikës së hershme të Queer Nation që është mbajtur në mend dhe është cituar. Në të vërtetë, ky agresion, që ishte përfshirë në mënyrë të famshme me sloganin “Queers Bash Back, ishte paraqitur në fletushkë si një forcë e cila do t'i bashkonte personat “queer”. Aktivizmi Queer në vitet e vonshme të 1980 përfaqësonte një qëndrim ekstrovert dhe konfrontues në mes të personave të ri gej. Duke i brohoritur sloganet siç ishte “Ne jemi këtu, Ne jemi Queer, Mësohu me Këtë” shënoi fundin e një politike ku personat LGBT në mënyrë të “ëmbël dhe të sjellshme” pritnin përmirësimet në legjislacion dhe në qëndrimet e botës. Queer Nation ringjalli fjalën queer, që është një emër i homoseksualeve i përdorur më së shumti në gjuhën angleze gjatë viteve 1900.

Duket që nuk ekziston një shpjegim i besueshëm historik se si termi queer mori kuptimin homoseksual por historiani George Chauncey në librin e tij “The Gay New York” diskuton se meshkujt që kishin interesim tek meshkujt e tjerë e kanë perceptuar veten si mashkullor dhe dëshironin ta theksojnë këtë veti duke u distancuar nga të dukurit “si vajzë”, ku kanë filluar të përdorin fjalën queer si një fjalë vet-identifikuese në 1910. Ripërdorimi i kësaj fjale urryese ishte një veprim kontrovers nga Queer Nation. Ata e “rivendosen” dhe bënë që fjala të tingëllojë pozitive. Një shpjegim i thjeshtë se pse kjo fjalë negative papritmas filloi të përdorej si fjalë pozitive është për shkak të gjeneratave të viteve 1960 dhe 1970. Aktivistët gay të viteve 1960 dhe 1970 kanë përvetësuar emrin gay dhe queer për të dalluar agjendën politike nga viti 1950, të ashtuquajturën “lëvizja homofile”.

SIDA ndryshoi në mënyrë radikale kushtet e homoseksualeve në përfundim. Në Shtetet e Bashkuara, klubet gej janë mbyllur, dhuna dhe paragjykimi ndaj homoseksualeve është rritur. Kur mijëra e meshkujve homoseksualë filluan të sëmurën dhe pastaj të vdisnin nga SIDA në vitet 1980, aktivistët gej kuptuan se ishte shumë më me rëndësi të përkrahen në mes veti se për shembull të diskutojnë se kush në komunitetin gej/queer ka imazh të “duhur”. Manifestimet e Queer Nation mbi këtë situatë historike sfidoi dhe bëri që të gjithë jo-heteroseksualet të luftojnë dhe në mënyrë të qartë të dhunën nga shumica heteroseksuale në shoqëri. Ky ishte një “deklarim i luftës” kundër heteroseksualitetit dhe homofobisë. Koha e kompromiseve tani ka përfunduar.

“Queer” është bërë një koncept i rëndësishëm si në mënyrë shoqërore ashtu edhe në atë intelektuale duke ndihmuar të zgjerohet ajo që kryesisht ishte lëvizje shoqërore gej dhe lezbike në një që ishte më gjithpërfshirëse të biseksualeve dhe personave transgjinerorë. Më shumë se një paraqitje e llojit të caktuar të identitetit seksual, “queer” përfaqëson çfarëdo numri të pozicionit i drejtuar kah kundër pozicioni në normat shtypëse shoqërore dhe kulturore dhe politikat që lidhen me seksualitetin dhe gjininë. Domosdoshmëria politike e të kuptuarit të lidhjes së gjinisë dhe seksualitetit në këtë lëvizje të zgjeruar shoqërore ndihmoi në nisjen e fushës së “studimeve queer” në edukimin e lartë.



**NE JEMI KËTU,  
NE JEMI QUEER,  
MËSOHU ME KËTË!**



# QUEER Heterosexuality isn't Normal, just common!

By Lola Krasniqi

The term "Queer" is difficult to define, and it can mean everything from criticism to theory, depending on how you choose to look at it. The criticism is, (or can be seen as) discontent that gay bisexual and transgender people express not to "fit in" and constantly be in the margins of the world in which power and privilege exists. Queer activism in the forms of different actions is also another way to openly criticize the normative heterosexual society that does not give room for, and discriminate queers, i.e. individuals who do not fit into the normative framework.

As a theory, the queer theory however, is a new way of seeing and understanding the world, a way that would be more inclusive and open to both gay, lesbians, bisexuals, transgender, asexual, etc. In the theoretical area there three central themes can be distinguished: heteronormativity, sexuality and gender.

Queer is a term that is more "wide" and inclusive than the terms gay and lesbian. It includes all those who place themselves outside the normative heterosexuality (even heterosexuals who do not behave according to the heterosexual norm). Queer is not regarded as a clear and definable identity. A famous and well known queer theorist is Don Kulick, Professor of Social Anthropology at Stockholm University and his formulation of queer reads: "a word that denotes both a specific way to analyze and act in society and the identity that has developed thanks to the ability to see through society in a politically conscious way.


## Queer Theory

Queer theory emerged in the U.S. with roots in gay activism, feminism, post-structuralism, and philosophy and "gay and lesbian studies." The word queer originally means "different" or "deviant" and as a science the Queer theory gives attention to functions of society that has to do with power, sexuality, normalized capacity and gender. It is not interested to show what others see as the norm aberrant (non-heterosexual) but instead includes it in the "standard norms". There is not only a queer theory as queer theory rather is a collective name for various critical perspectives on sexuality. Queer theory is a number of different perspectives. Identity, Society and culture can be interpreted in a number of ways. But a common denominator queer theorists have is that they want a broader focus on sexuality in society, they do not want to study the "deviant", but instead, be concerned how sexual norms arise, works, is maintained and followed. Questions that can be raised is: "What is sexuality? How have perceptions of sexuality changed historically? What relationship has

sexuality to notions of femininity and masculinity? And what has power to do with it? "The emphasis is to observe that sexuality is somewhat ambiguous and can not easily be explained, identified and/or separate from other phenomena, but sometimes sexuality is about identity, sometimes an act, sometimes you can analyze it best through a system of norms and sometimes it is a desire.

The term is also sometimes used as an umbrella term for everything that does not fit into a heterosexual norm. Instead of specifying queer as an exact specifically distinct theory or category, many researchers says that queer theory instead is "to move on, disrupt and break up the different categories and standards."

Queer theory has different research fields but the most common is heteronormativity. Heteronormativity means that one assumes that we all live a heterosexual life and / or that it is the most natural way of life. This assumption is done daily by the institutions, laws, relations and actions such as when same-sex couples are not included in marital-law, when the national health care does not allow insemination of lesbians or that an LGBT perspective is ignored when writing an educational book. Those who are treated as "non- heterosexual" is something that is not included in the norm and becomes abnormal when compared to the "normal". A queer theorist wants to see how identities, acts, rules, norms and beliefs are woven together into what is called sexuality. One of queer theory benchmarks is that normalization is linked to power



## **Queer in Politics - The rebirth of the word QUEER**


For many, queer is not queer without a radical political edge. Queer activism implies a challenging approach to sexual politics and it shuns neither controversy nor confrontation. Discussions about the political radicalism of queer activism usually revisit the model of all queer activism, the organization Queer Nation that has been credited for the first use of queer as a political signifier in the legendary flyer with the titles "Queers Read This!" and "I Hate Straights!" on either side.

Grown out of the frustration with the willful mismanagement of the AIDS crisis by the government and with increased violent homophobia, discrimination, and hostility to add insult to injury, the embracement of anger and violent response is the sensational feature of the flyer and the early politics of Queer Nation that is remembered and quoted. Indeed, this aggression, famously expressed in the slogan "Queers Bash Back!", was represented in the flyer as the force that would unite "queers". Queer Activism in the late 1980s stood for a extroverted and confrontational attitude among young gay people. By chanting slogans such as "We're Here, We're Queer, Get Used To It" it marked the end of a policy where LGBT people in a "sweet and polite" way would await any improvements in legislation and the outside world's attitudes. Queer Nation revived the word queer, which is one of the most used names of homosexuals in the English language during the 1900s.

There seems to be no reliable historical explanation of how the term queer got its homosexual meaning, but the historian George Chauncey discusses in his book "The Gay New York" how the men who were interested in other men, but they perceived themselves as masculine, wanted to highlight their distance to "sissy-ness" began to use queer as a self identified word as early as the 1910s. To now re-use this hateful word was a controversial move by Queer Nation. They "reclaimed" the word and made it positive. A simple explanation to why this negative word suddenly started to be used as a positive word, is because of the generation of the 1960 and the 1970's. The 1960 and 70s gay activists had adopted the name gay and Queer to differ the political agenda from the 1950's so-called "homophile movement."

AIDS radically changed conditions for homosexuals in the west. In the United States, gay clubs shut down, violence and prejudice against homosexuals increased. When thousands of gay men began falling ill and then die of AIDS in the 1980s, the gay activists discovered that it was far more important to support each other than, for example, discuss who in the gay / queer community had the "right" image. Queer Nation manifestations of this historical situation, challenged and asked all non-heterosexuals to fight back, to clearly mark thoroughly revulsions from the heterosexual majority in the society. It was a "declaration of war" against heterosexism and homophobia. The time of compromise was now over.

Just as importantly, "queer" became an important concept both socially and intellectually, helping to broaden what had been primarily a gay and lesbian social movement into one that was more inclusive of bisexual and transgender people. Rather than denote a particular genre of sexual identity, "queer" came to represent any number of positions arrayed in opposition to oppressive social and cultural norms and policies related to sexuality and gender. The lived political necessity of understanding the nexus of gender and sexuality in this broadening social movement in turn helped launch the field of "queer studies" in higher education.



**We 're Here,  
We 're Queer,  
Get Used To It!**



# YLBËR MBRËTEROR

## MBI QIELLIN PLOT DASHURI TE AMSTERDAMIT

*Njerëz strejt kudo. Natyrisht persona strejt, pasi që nënkuptohet se ata janë shumicë në numër. Ashtu u ka qëlluar fati. Por për shkak se ishin shumë të lumtur që po e çmonin dashurinë në mes njerëzve gej, shumë prej tyre ishin mbledhur për ta ndjekur ngjarjen e krenarisë këtë vit në Amsterdam.*

*Në atë që quhet Parada e Kanalit e cila është mbajtur me 4 gusht këtë vit, njerëz me seksualitete dhe identitete të ndryshme erdhën së bashku për të kremtuar emëruesin e përbashkët të njerëzimit: dashurinë. Ishte padyshim një marshim i krenarisë së gejëve, lesbikeve, biseksualëve dhe individëve transgjinorë por që në fund doli të jetë vërtetë veçantë dhe mrekullueshëm. Nuk kishte mundur të jetë më mirë. Moti ishte me diell, me pika të herëpashershme freskuese shiu, muzika e bukur, publiku i hareshëm pranë kanaleve të famshme të cilët të gjithë donin ta ndajnë gëzimin dhe krenarinë.*

*Ndryshe nga paradat kiç që mbahen në Evropë dhe të cilat nuk janë asgjë tjetër përpos mburrjes dhe tregimit të trupave, parada e këtij viti në Amsterdam ka sjellë një ngjarje kumbuese si dhe paradë gazmore dhe të gjallë. Secila varkë që lundronte nëpër kanale kishte një temë siç ishin: forcat ushtarake dhe policore holandeze me pjesëtarë të tyre gej, familjet e personave LGBT, organizatat LGBT, grupet përkrahëse, artistet, vullnetarët, etj. Varkat më mbresëlënëse ishin ato me politikanët holandezë dhe tjetra me gejë dhe lesbike turke e cila më vonë fatkeqësisht ishte në qendër të kërcënimeve nga disa ekstremistë myslimanë që jetojnë në Holandë. Besoj që ky rast kërcënues ishte e vetmja njollë e zezë në këtë ditë të tërëtë ëndërrave.*

*Amsterdami është me të vërtetë njëri nga qytetet kryesore të botës kur është fjalë e të qenit liberal dhe miqësor ndaj gejëve. Megjithatë, mund ta pyesni veten pse një paradë e krenarisë është e nevojshme këtu. Mirëpo, pavarësisht nga pranimi i gjerë të popullatës së përgjithshme, homoseksualiteti nuk qëndron mirë as në Holandë. Ka sulme sporadike kundër personave LGBT dhe ekzistojnë politikanë të caktuar – fatmirësisht të paktë në numër – që përdorin të drejtat e LGBT-së për të luajtur shpesh poker politik.*

*Çka më befasoi më së shumti gjatë pjesëmarrjes sime në këtë ngjarje ishte se unë isha në varkën ku shumica e të ftuarve ishin personat straight. Po, edhe kjo ekziston – parada gej e personave straight, me gjithë faktin se sa e çuditshme kjo mund t'u tingëllojë disa lexuesve. Ata ishin aty për ta kremtuar tolerancën, barazinë, njerëzimin, paqën të cilat qytetarët e Amsterdami i kanë pranuar ose thjeshtë – për të kremtuar dashurinë. Në fund, a është aq me rëndësi të ndahen njerëzit kështu duke i etiketuar ata? Gej, strejtt, interseksual, queer, lesbike, biseksual, aseksual. A është aq e rëndësishme kjo? E po, ja pse parada e krenarisë ishte më shumë një ngjarje kulturore, një shfaqje kulturore e dashurisë dhe demonstrim i domethënies së vërtetë të ylberit.*





# ROYAL RAINBOW OVER AMSTERDAM LOVE SKY

*Lots of straight people everywhere. Of course, straight people, since they represent the majority by default. But because they were so happy to cherish the love between the gay people, many of them gathered to see the pride event in Amsterdam this year.*

*In what is called the Canal Parade which took place on August 4 this year, people of different sexuality and identity came together to celebrate one common denominator of humanity: love. It was certainly the pride march of gays, lesbians, bisexuals and transgender people, but in the end it turned out to be really queer and fabulous. It could not be any better. The weather was sunny with intermittent refreshing drops, lovely music, beautiful people, cheerful audience alongside the famous canals who all wanted to share the joy and pride.*

*Unlike many kitsch parades around Europe which are nothing new but just a show-off of personal bodies, this year's Amsterdam's pride brought a vibrant and a very gay and colourful parade. Each boat that sailed through the canals had a theme, such as: the Dutch military and police forces with openly serving gay members, groups of families of LGBT people, LGBT organisations, support groups, artists, performing volunteers etc. The most impressive boats were the one with the Dutch politicians on board and the other one with the Turkish gays and lesbians, which unfortunately was a centre of threats by some Muslim extremists living in the Netherlands. I guess, this threat case was the only black stain of the entire dream-day.*

*Amsterdam is really one of the leading cities around the world when it comes to being liberal and gay-friendly. However, one could wonder why is a pride parade needed there then. Well, despite the widespread acceptance amongst the general public, homosexuality is still not in good terms in the Netherlands either.*

*There are sporadic attacks against LGBT people there and there are certain politicians – fortunately small in number – who use the LGBT rights to often play political poker.*

*What struck me most during my participation in this event was that I was in a boat where the majority of guests were straight people. Yes, it exists – the gay pride of straight people, no matter how odd this may sound to some readers. They were there to celebrate the tolerance, the equality, the humanity, the peace that Amsterdamers embraced or if put it simply – to celebrate the love. Does it really matter in the end to put people into boxes by labelling them? Gay, straight, intersexual, queer, lesbian, bisexual, asexual. Does it really matter? Well, that is why this pride edition was rather a cultural event, a cultural show of love and a demonstration of the true meaning of the rainbow.*



# Tregim personal

Do ta nis këtë tregim personal me një thënie shumë me vend e cila thotë: "Duhet guxim të rritesh dhe të kuptosh kush në të vërtetë je." Jam rritur me vllain tim dy vite me t'moshuar se unë, kemi qënë të pa ndarë, pasi ishim fëmijët e parë në familje. Shkoja kudo që shkonte ai, bëja gjithçka që bënte ai, luaja me shokët e tij (meshkuj), lojëra meshkujsh, domethënë jetoja në një botë mashkullore. Unë nuk kam qënë gjithmonë lezbike. Mbjaj mend të më kë në pëlqyer meshkujt si e vogël, por më duhet të shtoj që ata pak meshkuj që më kanë tërhequr kanë pasur karakteristika femrore, mbi të gjitha duhej të ishin me natyrë shumë të butë. Koha po kalonte dhe unë po rritesha në atë botë mashkullore, vishesha me rroba meshkujsh, që shumicën e rasteve ia huazoja vllait. Me kujtohet nëna ime atë kohë më detyronte të vishja fustane për të shkuar në shkollë, dhe sa herë mi vishte, qaja, sepse nuk ndihesha mirë në atë veshje. Momenti i parë kur unë e mbaj mend të më ketë pëlqyer një vajzë, ishte kur unë isha 10 vjeqare. Atë e kisha në klasë, atë kohe ishte koha e luftës në Kosovë dhe unë me familjen time gjindeshim në Perendim. Atë kohe nuk e kuptoja pse me pëlqente aq shume ose pse sa herë e shihja ose bisedoja me të bëhesha e turpshme. Pesë vite me vonë, kur unë dhe familja ime veq ishim kthyer në atdhe, sepse lufta kishte përfunduar, isha në shkollë fillore dhe mbaj mend të tërhiqesha nga të dy gjinitë. Por gjithmonë ngurroja t'ia pranoja vetës tërheqjen që kisha ndaj vajzave, kisha frike t'ia pranoja vetes. Jam rritur në një frymë religjioze në familje dhe e dija mirë çfarë thoshte Zoti për Homoseksualizmin. Shpesh herë kjo gjë më ka bërë të mendoj shumë dhe ti ndaloj mendimet apo fantazitë e

mija në gjysmë, por ishte më e fortë se unë. Me kalimin e kohës ndjenjat e mija për femrat rriteshin fuqishem sa s'mundja t'i ndaloja, kurse mashkujt as që më interesonin më. U dashurova në shoqen timë të klasës, një vajzë për perceptimin tim të atëhershëm 'Perfekte'. E doja aq shumë, e mbaja kudo foton e saj, në qatën time, në brendi të kitarës sime dhe pothuajse të gjithë në shkollë e dinin që unë e kisha për qejfi. Kishin filluar fjalët që 'Unë e dashuroj atë'. Dhe kur dëgjova se kshtu kishin thënë, u shtanga dhe u friksova në të njëjtën kohë, sepse mentaliteti këtu ishte larg atij perendimor dhe do të të përqeshnin e të të shanin besa besa do të të quanin të sëmur po t'jesh homoseksual. E kisha frikën te familja se nuk ma ndiente për rrethin. E dija që shoqja në të cilën unë isha dashuruar friksohej nga lezbiket, ma kishte thënë një herë dhe mendoj që e kishte bërë me qëllim sepse dyshonte në mua. Prapë se prapë erdhi dita dhe une vendosa ti tregoja për dashurinë që ndjeja për të dhe se unë pelqej femrat. Këtë e bëra me mesazhe në telefon, sepse nuk kisha guxim t'ia thoja në sy. Më është dashur shumë guxim ta bëja këtë, më besoni. Ajo u terbuja, tha që nuk është më shoqja ime, tha t'i djegia të gjitha fotografitë ku ishim bashk. Nuk mendoj që mund ta imagjinoni si jam ndier. Por më vonë u pajtua me këtë fakt dhe vendosëm të ishim vetem shoqe, siq ishim gjithmonë. Pajtimi i saj më ndimoi edhe mua ta shoh vetëm si shoqe dhe ta respektoja si të tillë. Isha 18 kur unë i tregova nënës time se më pelqenin vajzat. Erdhi puna që mu dasht patjeter ti tregoja se përndryshe nuk mendoj se do e kisha bërë, të paktën jo në atë kohë. Reagimi i saj ishte ashtu sic e kisha prit, më tha: "Ki mendjen çfarë po flet, mos të dëgjoj babai këto fjalë se

të hedh në sokak", dhe më kurrë nuk më ka folur për këtë temë. As unë nuk ia kam hedhur fytyrës. Fillova fakultetin dhe bashk me të filloi gjithçka, dashuria, seksi, e gjithçfarë ndjenje e re për mua. Vjen një ditë në jetën tuaj dhe e kuptoni kush jeni, çfarë mendoni për jetën, çfarë doni nga jeta dhe pothuajse gjithçka rreth vetes tuaj. Kjo ka ndodh edhe me mua. Jam lezbike, e cila një ditë ëndërron të martohet me një femër dhe të këtë fëmijë, thjeshtë një jetë normale si çdokush tjetër në botë, dhe do ta arrij këtë synim. Nuk mendoj që kam lind lezbike, por çka ndikon të shumica e njerzve, për mendimin tim është fëmijëria që ata kanë, rrethanat në të cilat rriten, krejt kto ndikojnë në formimin e personit që ata një ditë bëhen. Unë jam rritur në një botë mashkullore, kam vepruar e jetuar si mashkull dhe një ditë si pasojë edhe kam dashuruar si mashkull. Familja ime e dijnë të gjithë për orientimin tim seksual, disave jau kam treguar personalisht, të tjerët e kanë kuptu, prap më kanë pranuar mirë dhe ndihem e bekuar që familja ime e din dhe prap më duan dhe respektojnë shume, si unë ata. Edhe pse nuk e kanë pasur aspak të lehtë ta pranojnë këtë fakt, sepse kanë hasur në shumë fjalël, babai në punë, nëna te familja e sa, motrat dhe vllai në shkollë, por kurrë nuk mi kanë treguar mua. Ndihem e bekuar sepse di që shumë lezbike tjera e kanë shumë më të vështirë të tregojnë kush janë dhe çfar ndjejne. Nuk e fsheh kurrë kush jam dhe krenohem që së pari e njoh veten dhe veproj në përputhje me ndjenjat e mija.



# Personal Story

